

FJALA E DEPUTETES ALBANA VOKSHI

E ENJTE 6 TETOR 2022

Në fakt, nuk e kuptoj fare se çfarë vlere ka fjala ime apo edhe e zotit Vasili, apo edhe e zotit Baçi, kur votimi ka ndodhur. Pra, ne flasim për një projektligj i cili është miratuar. Nuk e kuptoj as vendimin përse merret, ku në mes të diskutimit një projektligj votohet. Thjesht për komoditetin e ministrave apo të deputetëve që vijnë në një orar, votojnë dhe largohen? Shikojeni sallën. Ka deputetë sa gishtat e vetëm një dore dhe vetëm dy ministra. Atëherë, për çfarë flasim? Unë do të doja t'i bashkohesha edhe kërkesës së zotit Vasili, ashtu siç edhe kolegët e mi deputetë kanë kërkuar, që votimi të bëhet në fund, ashtu sikurse ka qenë tradita.

Të diskutohet, se ndoshta ka një reflektim nga qeveria, ndoshta mund të ndryshohet ndonjë nen dhe ky, në fakt, është edhe koncepti i diskutimit të një projektligji. Për të kaluar te projektligji, gjithsesi, unë e kam përgatitur fjalën time dhe, në respekt të të gjithë qytetarëve që po na ndjekin, do të vijoj me të. Së pari, dua të falënderoj qeverinë japoneze për mbështetjen gjeneroze të projektit për përmirësimin e pajisjeve për konservimin, restaurimin e mjedisit ekspozues në Muzeun Historik Kombëtar! E falënderoj edhe për faktin që, shqyrr janë këta donatorë, të cilët mbështesin restaurimin e muzeve, sepse një gjë është e sigurt: ashtu sikurse ka qenë edhe një plan që është shpërndarë në disa portale, edhe muzeu do të kishte fatin e Teatrit Kombëtar dhe në vend të tij do të shihnim një tjetër kokë të Skënderbeut të ministres. Sot është data 6 tetor.

Pra, jemi në muajin tetor apo siç quhet ndryshe edhe Tetori Rozë, por, përveç ngjasimit me ngjyrën e fjongos, që përdoret si simbol i këtij muaji, tetori për gratë shqiptare nuk e ka ngjyrën rozë, përkundrazi. Shihni sot Kuvendin. Nuk ka asnjë foto, nuk ka asnjë banner. Nuk ka ndodhur kurrë, në fakt, është hera e parë. Duhej të kishte të paktën diçka sensibilizuese në këtë muaj, të paktën 1 muaj dhe nuk ju harxhon aspak. Mund të kishte një mesazh. Sot nuk kishte fjongo. Pra, Ministria e Shëndetësisë nuk ishte kujdesur për të sjellë as fjongo për kolegët deputetë. Pra, atje ku nuk ka tenderë, nuk ka interes nga qeveria. Atje ku nuk ka para, nuk ka interes nga

qeveria. E, sigurisht, shëndeti i grave dhe i vajzave nuk është prioritet për këtë qeveri. Nuk pati asnjë mesazh nga Kryeministri sot.

Unë nuk kam dëgjuar ndonjë ministre sot që ta hapë apo ta mbyllë fjalën e saj me një mesazh sensibilizues, madje as Kryetarja e Kuvendit nuk e ka bërë një gjë të tillë sot. Për më tepër, mund të kishte urdhëruar Shërbimin e Seancave që sot të kishim mesazhe. Duhej të ishte mbushur kjo sallë me mesazhe sensibilizuese, minimumi që ne duhej të bënim sot si Kuvend. Për kuriozitet, hyra në faqen e ministres së Shëndetësisë për të parë planin e sensibilizimit të këtij muaji. Duhej të kishin vërshuar deputetet e maxhorancës, të opozitës; duhej të kishin vërshuar ministret në çdo rrugë të takonin gra dhe vajza për të sensibilizuar. Pse? Sepse statistikat janë kokëforta dhe tronditëse. Nuk kishte asgjë, veçse foto të një marshimi.

Shumë mirë, marshimi duhet, është sensibilizim, si dhe një video me një kampione të atletikës, të cilën, në fakt, e falënderoj pa fund, sepse ka marrë kohë nga koha e saj e çmuar për të bërë një video dhe për të dhënë një mesazh sensibilizues. Kaq ishte plani i sensibilizimit të Ministrisë. Madje-madje, nuk kishte as shifra! Përveç një raportimi të drejtuesit të ISHPsë, nuk gjen gjëkund as plan sensibilizues, as planin e qeverisë, as çfarë është bërë në këto vite, as krahasim, as analizë, as studime. Pse? Sepse gratë nuk janë prioritet për këtë qeveri. Por, ndryshe nga qeveria, për Partinë Demokratike gratë, po, dhe shëndeti i tyre është prioritet, madje është prioritet kryesor. Ndaj, edhe si strukturë e Partisë Demokratike, ne kemi nisur të bëjmë atë çfarë qeveria nuk e bën: të kemi një plan konkret sensibilizimi.

Dje, së bashku me kryetarin e partisë, së bashku me kryetarin e grupit parlamentar, zotin Boçi, shkuam të takonim gra dhe vajza të Elbasanit, që është njëri nga qytetet më të prekura nga kjo sëmundje. Kemi dëgjuar histori tronditëse. Kemi dëgjuar mjeke të cilave u dhimbsej vetja, se nuk u vinin dot në ndihmë grave dhe vajzave, sepse nuk jepnin dot shërbimin shëndetësor, i cili në Kushtetutë duhet siguruar. Kemi dëgjuar mësuese të cilat nuk e merrnin shërbim shëndetësor, nuk e merrnin mbështetjen as për mamografi, as për kurim, por në të kundërt detyroheshin të bënin check up-in e Vilmës, sepse përndryshe nuk shkonin dot të jepnin mësim për nxënësit, e shumë histori të tjera.

Kështu do të vazhdojmë gjithë muajin dhe jo vetëm, por do të vazhdojmë me një fushatë intensive sensibilizimi, duke shkuar në çdo lagje, duke shkuar në çdo rreth, duke shkuar në çdo bashki. Pse? Sepse qeveria mungon. Pse? Sepse për Partinë Demokratike shëndeti i grave dhe i vajzave është prioritet! Cilat ishin disa nga statistikat që unë doja sot t'i ndaja? Në pesë vjetët e fundit ka më shumë se 700 gra të prekura nga kanceri i gjirit. Pra, dy gra në ditë preken nga kjo sëmundje, ndërkohë që 220- 230 gra në vit e humbin betejën e tyre me këtë sëmundje. Këto janë shifrat e pesë vjetëve të fundit. Në vitin 2021, sipas statistikave zyrtare të ISHP-së, pati 715 raste të reja, 230 humbje jete. Dy gra, pra, janë prekur në ditë. Edhe vitin e fundit ka pasur 30% më shumë shtrime. Po në vitin kryesor të pandemisë, çfarë ka ndodhur?

Ka gati 1000 raste të reja të zonjave, të cilat, siç duket, për shumë e shumë arsye, qoftë edhe prej mungesës totale të shërbimit shëndetësor, janë evidentuar me kancer gjiri (pra, tri gra në ditë) dhe 300 gra e kanë humbur betejën e tyre. Kjo vërteton edhe një herë studimin, raportin e Këshillit të Europës, i cili thotë se gjatë pandemisë, niveli i i vdekshmërisë në Shqipëri ishte më shumë se dyfishi i mesatares së vendeve të Bashkimit Europian. Ja pra, ku janë faktet dhe ato janë kokëforta. Çdokush do të mendonte që, meqenëse kemi një grua në krye të Ministrisë së Shëndetësisë, ajo do t'i mbështeste më shumë gratë dhe vajzat me politika mbështetëse, do të kishte më shumë përkujdesje. Por jo. Gjatë pandemisë ministrja u kujdes të bënte tenderë sekretë edhe për letra higjienike, por nuk u kujdes për shëndetin e grave dhe të vajzave.

Sot ministrja vazhdon të paguajë për sterilizimin apo për PPP-të e tjera abuzuese, por në QSUT kimioterapi herë ka dhe herë nuk ka. Sot ministrja paguan 400 euro për një set sterilizimi, ndërkohë që duhej të paguajë vetëm 2 euro, por ka vetëm 6 kabinete kimioterapie dhe mjekimi bëhet i centralizuar në QSUT. Sot Rama paguan 4 milionë euro për një instalacion druri për të kënaqur sytë e tij, por aparati i kobaltit nuk punon ashtu siç duhet. Ju lutem, mos më ndërhyjni nga vendi! Po të doni, merreni fjalën pas meje. Është pra, se e kam informacion nga mjekët që punojnë në QSUT. Pacientët detyrohen të shkojnë në klinika private apo jashtë vendit. Ku është shëndetësia falas që premtoi Edi Rama? Shëndetësia falas është kthyer në mashtrim, dhimbje dhe vuajtje falas për qytetarët shqiptarë.

Meqë detyrohen të vijnë në Tiranë, shpenzimet e transportit dhe hotelerisë janë marramendëse. Nga një studim që ka bërë shoqata Together for Life, ka rezultuar që një familje shpenzon 750 mijë lekë të vjetra në muaj, që është shumë herë më e madhe edhe se paga mesatare. Në fund të fjalës sime dua të jap një mesazh, që sot ka munguar, dhe t'u bëj ftesë të gjitha ministreve, deputeteve, por edhe zotërinjve deputetë, që të paktën deri në fund të muajit të mos kursejnë një mesazh drejtuar grave: "Mamografia shpëton jetë, testet shpëtojnë jetë".

Ndaj, i ftoj të gjitha gratë të mos hezitojnë, por të bëjnë testet dhe mamografinë, sepse sëmundja nuk bashkëpunon, qeveria mungon, ndaj ato duhet ta mbrojnë vetë veten e tyre. Të nderuara zonja, bëni mamografinë dhe testet, sepse kështu shpëtoni jetën tuaj dhe familjet tuaja! Faleminderit!